



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

QERSHOR 2023

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Qershor 2023

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023
Drejtoria e Përgjithshme e Programimit Makroekonomik
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: Dajana.Metolli@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE _____ **2**

ZHVILLIMET EKONOMIKE _____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit _____ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit _____ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave _____ 5
4. Bilanci i Pagesave _____ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar _____ 7
6. Kredia për Ekonominë _____ 8
7. Oferta e Parasë _____ 9
8. Depozitat sipas burimeve _____ 10

SEKTORI FISKAL _____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar _____ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve _____ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal _____ 13

ANEKSI STATISTIKOR _____ **13**


Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Qershor 2023, arriti në 113.95;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin Qershor 2023 ishte 4.53 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Qershor 2023 ishte 99.05 lekë për dollarë dhe 107.26 lekë për euro;
- Normat mesatare të interesit të depozitave në lekë sipas individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit Qershor 2023 shënuan kuotën 1.46 dhe 1.22 përqind;
- Normat mesatare të interesit të huave në lekë sipas Individëve dhe korporatave jo-financiare gjatë muajit Qershor 2023 shënuan përkatësisht vlerat 6.75 dhe 6.64 përqind;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,633,690 milionë lekë në muajin Qershor 2023, duke shënuar një rritje prej rreth 1.4 përqind krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të 2023 rezultoi me rritjen e mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 83.27 milionë euro;
- Situata Buxhetore për periudhën Qershor 2023 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej rreth 46.16 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një sufiçit prej 6.32 miliardë lekë;
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Qershor 2023, arritën në rreth 319.99 miliardë lekë ose afërsisht 4.5% më shumë se të ardhurat e planifikuara për këtë periudhë;
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 273.84 miliardë lekë ose rreth 8.7% më pak se shpenzimet të planifikuara për këtë periudhë;

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Qershor 2023 ishte 4.5%, një vit më parë ky ndryshim ishte 7.4%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Qershor 2023, krahasuar me Maj 2023 është -0.3%. Një muaj më parë, Maj 2023, IÇK shënoi një rënie mujore prej 0.3%. Referuar një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Qershor 2022 shënoi rënie mujore prej 0.1%, në krahasim me muajin paraardhës.



Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- “Ushqime dhe pije joalkolike” me rritje vjetore të çmimit prej +10.3%, duke kontribuar me +3.63 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +4.5%.
- “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje”, me rritje vjetore +6.2%, duke kontribuar me +0.45 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +4.5%.
- “Qera, ujë lëndë djegëse dhe energji” me rritje vjetore të çmimit prej +2.1%, duke

kontribuar me +0.40 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +4.5%.

- “Argëtim dhe kulturë” me rritje vjetore të çmimit prej +10.3%, duke kontribuar me +0.24 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +4.5%.
- “Hotele, kafene dhe restorante” me rritje vjetore të çmimit prej +4.8%, duke kontribuar me +0.22 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +4.5%.
- “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me rritje vjetore të çmimit prej +4.0%, duke kontribuar me +0.22 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +4.5%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2022	3.7	3.9	5.7	6.2	6.7	7.4	7.5	8	8.1	8.3	7.9	7.4
2023	7.2	7.1	5.3	4.6	4.7	4.5						

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit


Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Qershor 2023, arriti në 107.26 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 3.45 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Qershor, një euro u këmbye me 106.44 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Qershor 2023 arriti në 99.05 lekë/dollarë duke shënuar rënie në vlerë me 3.14 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit Qershor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 98.15 lekë/dollarë.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatar rreth 0.92 dollarë/euro për muajin Qershor 2023.


Në krahasim me muajin Qershor të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezultojnë se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 10.46 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezultojnë se është mbiçmuar në masën 12.54 përqind. Rënia e monedhës euro ka ardhur si pasojë e numrit të lartë të turistëve të huaj dhe të flukseve valutore hyrëse nga turizmi. Forcimi i monedhës vendase ndaj euros këtë vit ka ndihmuar në zbutjen e pjesshme të presioneve inflacioniste nga jashtë.

Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, forcimi i lekut mund të shpjegohet me përmirësimet në bilancin e llogarisë korrente, rritjen e investimeve të huaja direkte, por edhe me efektet e normalizimit monetar dhe rritjes së normave të interesit si dhe si rezultat i stabilitetit të situatës makroekonomike në vend.




3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Qershor 2023, normat mesatare të interesit të depozitave me afat në lekë sipas Individëve dhe Korporatave jo-financiare shënuan përkatësisht vlerat prej 1.46 dhe 1.22 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave sipas individëve dhe Korporatave jo-financiare kanë shënuar rënie përkatësisht 0.10 dhe 1.77 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë kanë shënuar rritje me 0.58 pikë përqindje për Individët dhe 1.41 pikë përqindje për Korporatave jo-financiare.



Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore për muajin Qershor 2023 kanë shënuar kuotën 3.27 përqind, nga 2.43 përqind që shënonte për të njëjtën periudhë një vit më parë. Bonoja 12-mujore pati rritje vjetore përkatësisht me 0.84 pikë përqindje dhe rënie mujore me 0.38 pikë përqindje.

Gjatë muajit Qershor 2023 normat mesatare të interesit të huave sipas Individëve dhe korporatave jo-financiare shënuan përkatësisht vlerat 6.75 dhe 6.64 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të huave sipas individëve ranë me 0.21 pikë përqindje ndërsa normat e interesit sipas korporatave jo-financiare ranë me 0.09 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë kanë shënuar rritje me 0.12 pikë përqindje për Individët dhe janë rritur me 1.00 pikë përqindje për Korporatave jo-financiare.





4. Bilanci i Pagesave

Përgjatë tremujorit të parë të 2023, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi pozitiv, në rritje të mjetëve të rezervës valutore, prej rreth 83 milionë euro, krahasuar me tremujorin e parë të 2023 që shënoi vlerën -89.1 milionë euro. Për tremujorin e parë të 2023, llogaria korrente e ngushtoi deficitin në -135.2 milionë euro, krahasuar me tremujorin e parë të 2022 që ishte -250.0 milionë euro.

Në tremujorin e parë të 2023, llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në 120.7 milionë euro, krahasuar me 192.3 mln euro në tremujorin e parë të 2022. Për tremujorin e parë të 2023, IHD regjistruan vlerën 308.5 mln euro ose +1.9%, krahasuar me 302.8 mln euro në tremujorin e parë të 2022.

Në tremujorin e parë të 2023, zëri i shërbimeve të lidhura përgjithësisht me Turizmin regjistroi vlerën 624.0 mln euro, ose rreth +52.6% krahasuar me 408.8 mln euro në tremujorin e parë të 2022. Për tremujorin e parë të 2023, Remitancat janë në vlerën 213.7 mln euro, ose +16.1%, krahasuar me 184.1 mln euro në tremujorin e parë të 2022.





5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Qershor 2023, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 18,718 milionë lekë krahasuar me muajin Qershor të vitit 2022. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritje së mjeteve valutore neto të Bankës Qëndrore me 9,427 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 47,062 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 48,873 milionë lekë e Bankës Qëndrore.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,633,690 milionë lekë në muajin Qershor 2023, duke shënuar një rritje prej rreth 23,077 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 1.4 përqind.

Në muajin Qershor, sistemi bankar rezulton me rënie mujore prej 3,472 milionë lekë.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Qershor 2023 arriti në rreth 713.271 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje në vlerë me 11.252 milionë lekë, ose rritje me rreth 1.60 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (54.3%) dhe monedhave të huaja (45.7%).


Gjatë muajit Qershor 2023, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 56.7 përqind ose 404.347 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 38.2 përqind ose rreth 272.754 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 2.7 dhe 2.4 përqind apo 19.219 dhe 16.798 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Qershor 2023, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 67.9 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 26.7 përqind. “Korporata të tjera financiar” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.3 dhe 3.0 përqind secili.




7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 389.014 milionë lekë në fund të muajit Qershor 2023. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Qershor 2023 ka shënuar një rritje mujore prej 0.35 përqind dhe rritje vjetore prej 0.78 përqind, duke arritur nivelin 23.8 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.60 përqind, dhe rritje vjetore prej 1.32 përqind, duke shënuar nivelin 31.3 përqind.



Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Qershor 2023, kanë shënuar rritje vjetore prej 797 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 73.4 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Qershor 2023 shënuan rritje prej 4.293 milionë lekë në krahasim me muajin Qershor 2022. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 78.4 përqind të depozitave në lekë.





8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Qershor 2023, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 78.4 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 16.1 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 3.4 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.4 përqind dhe rreth 23.6 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 75.6 përqind e totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 941.101 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (252.496 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (23.446 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (25.663 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.970 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit Qershor 2023, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,244,676 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 8.356 milionë lekë. Ndërsa, krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 5.090 milionë lekë.




Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Qershor 2023 janë mbledhur rreth 319.993 miliardë lekë të ardhura, përkundërt shpenzimeve të përgjithshme prej 273.836 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 242.880 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 104.822 miliardë lekë në shpenzime për fonde speciale.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 204.373 miliardë lekë (3.2% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 15.362 miliardë lekë (12.8% më pak se plani i periudhës). Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 69.183 miliardë lekë (ose rreth 10.2% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 11.492 miliardë lekë (ose rreth 13.8% më pak se plani i periudhës).



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 242.880 miliardë lekë, 46.284 miliardë lekë (19.06% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 20.705 miliardë lekë (1.73% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 27.260 miliardë lekë (11.22% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 701 milion lekë (0.28% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 104.822 miliardë lekë (43.16%) për shpenzime për fonde speciale, 28.957 miliardë lekë (11.92% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 14.151 miliardë lekë (5.82% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Qershor 2023 ishin rreth 319.99 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 288.92 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 11.49 miliardë lekë.

Të ardhurat gjatë muajit Qershor 2023 (mln Lekë)			
Emërtimi	Qershor'23	Qershor'22	Qersh'23/Qersh'22 Rritja në (%)
Tatimi mbi Vleren e Shtuar	93,009	91,129	2.1
Tatimi mbi Fitimin	33,827	24,914	35.8
Akcizat	26,383	24,184	9.1
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	27,792	21,612	28.6
Taksa Nacionale dhe të tjera	19,121	22,975	-16.8
Taksa Doganore	4,241	3,905	8.6

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Statistikat Fiskale: Qershor- 2023

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 46.157 miliardë lekë për periudhën Qershor 2023, u mbështet kryesisht nga huamarrja e brendshme si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe huasë afatgjatë të huaj.

Për periudhën Janar-Qershor 2023, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 319.99 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 273.84 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave progresive për periudhën Qershor 2023, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 288.912 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 242.88 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 104.82 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly)					Vjetor (Annual)					Month
	2019	2020	2021	2022	2023	2019	2020	2021	2022	2023	2019	2020	2021	2022	2023	
Janar	1.6	1.9	1.3	1.3	1.1	1.6	1.9	1.3	1.3	1.1	1.9	1.5	0.4	3.7	7.2	January
Shkurt	0.6	0.4	1.1	1.3	1.1	1.1	1.1	1.2	1.3	1.1	1.7	1.2	1.1	3.9	7.1	February
Mars	-0.3	0.6	0.7	2.4	0.7	0.6	0.9	1.0	1.7	1.0	1.1	2.1	1.2	5.7	5.3	March
Prill	-0.2	-0.4	0.2	0.7	0.03	0.4	0.6	0.8	1.4	0.9	1.4	1.9	1.9	6.2	4.6	April
Maj	-1.0	-0.8	-0.9	-0.5	-0.3	0.1	0.3	0.5	1.0	0.7	1.5	2.1	1.8	6.7	4.7	May
Qershor	-0.3	-0.6	-0.8	-0.1	-0.3	0.1	0.2	0.3	0.9	0.6	1.3	1.8	1.6	7.4	4.5	June
Korrik	-0.1	-0.5	0.1	0.2		0.0	0.1	0.2	0.8		1.5	1.4	2.2	7.5		July
Gusht	0.3	0.2	0.4	0.8		0.1	0.1	0.3	0.8		1.5	1.3	2.4	8.0		August
Shtator	0.1	0.4	0.5	0.6		0.1	0.1	0.3	0.7		1.3	1.5	2.5	8.1		September
Tetor	-0.2	0.2	0.1	0.4		-0.1	0.1	0.3	0.7		1.3	2.0	2.4	8.3		October
Nëntor	-0.2	-0.5	0.2	-0.3		0.0	0.1	0.3	0.6		1.4	1.6	3.1	7.9		November
Dhjetor	-0.2	0.3	0.8	0.4		-0.1	0.1	0.3	0.6		1.4	1.1	3.7	7.4		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha					2023	2023	2023	2023	2023	2023	Currency
	2019	2020	2021	2022	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Mesatarja e periudhës:											Average of period
USD	109.85	108.65	103.68	113.04	107.90	107.98	106.91	102.45	102.26	99.05	USD
EURO	123.01	123.77	122.37	118.98	116.39	115.72	114.35	112.38	111.10	107.26	EURO
Fundi i periudhës											In the end of period
USD	108.64	100.84	106.54	107.05	107.72	108.43	103.96	101.12	102.76	98.15	USD
EURO	121.77	123.70	120.76	114.23	116.55	115.04	113.21	111.12	109.69	106.44	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)*Annual Interest Rates (in ALL)*

Në përqindje	2023	2023	2023	2023	2023	2023	In percent
	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Norma e interesit të depozitave për individë							Interest rates on households deposits
Deri në 1 vit	1.06	1.08	1.02	0.98	1.07	0.97	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	1.72	1.93	1.53	1.63	1.81	1.72	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	2.89	2.83	2.84	2.80	2.92	2.95	Over 2 years
Norma e interesit të depozitave për korporatat jo-financiare							Interest rates on nonfinancial corporations deposits
Deri në 1 vit	2.15	1.34	1.76	1.47	2.99	1.17	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	4.97	3.61	2.47	2.41	2.48	2.61	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	3.32	3.19	2.35	2.24	2.23	3.29	Over 2 years
Normat e interesit të kredive per individet							Interest rates on household loans
Kredi për banesa	4.41	4.31	4.42	4.23	3.96	4.30	Lending for house purchase
Kredi konsumatore	8.89	9.91	9.60	9.57	9.54	8.99	Consumer credit
Kredi për qëllime të tjera	12.66	15.26	9.15	9.29	10.43	10.13	Credit for other purposes
Normat e interesit të kredive per korporatat jofinanciare							Interest rates on nonfinancial corporations loans
Kredi deri në 140 milion lekë	7.89	7.61	7.68	6.76	7.00	7.26	Loans up to to an amount of 140 millions of lek
Kredi mbi 140 milionë lekë	6.09	7.00	7.54	5.83	6.48	6.26	Loans over an amount of 140 millions of lek
Norma e letrave me vlerë							Securities rates
Bono thesari 1/							Treasury bills 1/
3-M	3.03	2.76	2.80	3.05	3.00	-	3-M
6-M	4.57	4.37	3.26	3.29	-	3.18	6-M
12-M	5.19	4.46	3.94	3.87	3.65	3.27	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

Tab - 4 TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2023

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2023

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (In million ALL)

Nr.	E M Ë R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	50,274	97,112	156,107	207,513	258,192	319,993	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	1,297	6,854	7,309	8,357	9,390	19,583	Grants
II.	Të ardhura tatimore	47,343	86,850	143,527	191,290	239,176	288,918	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	33,341	60,922	104,674	135,967	169,169	204,373	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	16,977	30,519	45,902	60,497	76,829	93,009	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	2,397	4,875	21,608	25,831	29,262	33,827	Profit Tax
3	Akcizat	4,102	8,226	12,056	16,043	21,134	26,383	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	5,258	9,063	13,236	18,112	22,800	27,792	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	4,023	6,983	9,895	12,824	15,658	19,121	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	584	1,256	1,977	2,660	3,487	4,241	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,407	2,915	5,070	9,147	12,439	15,362	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	284	533	1,029	2,208	2,729	3,314	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	0	5	12	20	27	33	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,123	2,377	4,030	6,919	9,684	12,015	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	12,596	23,013	33,783	46,176	57,569	69,183	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	10,820	19,834	29,176	39,764	49,639	59,718	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,712	3,046	4,402	6,091	7,559	9,028	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	64	133	205	321	370	436	Compensation income in the value of owners
III.	Të ardhura Jotatimore	1,634	3,409	5,271	7,865	9,625	11,492	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	0	0	0	0	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	954	2,049	3,247	5,211	6,252	7,358	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	214	404	642	808	1,072	29	Utility fees
4	Të tjera	465	955	1,364	1,828	2,283	1,379	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	35,352	73,466	125,232	172,957	222,195	273,836	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	34,324	71,699	112,498	154,848	198,029	242,880	Current Expenditures
I.1	Personell	7,247	14,580	21,963	29,511	37,289	46,284	Personnel expenditures
1	Paga	6,218	12,504	18,832	25,305	31,958	39,664	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	1,020	2,053	3,087	4,134	5,230	6,440	Social insurance contributions
3	Arsimi I larte nga te ardhurat e veta	9	23	44	72	102	180	Higher education from its own income
I.2	Interesat	5,426	7,657	12,051	14,768	16,613	20,705	Interest
1	Të Brendshme	4,314	5,773	9,120	11,156	11,709	12,522	Domestic
2	Të Huaja	1,112	1,884	2,932	3,612	4,903	8,183	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,635	5,742	10,294	14,785	22,000	27,260	Operational & Maintenance
I.4	Subveclonet	79	266	378	499	600	701	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	15,616	32,037	48,598	68,462	86,118	104,822	Social Insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	12,576	24,399	36,771	52,114	65,338	79,182	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	3,032	7,202	11,292	15,815	20,247	24,748	Health insurance
3	Fondi I kompensimit të pronarëve	8	436	535	532	534	892	Owners' Compensation Fund
I.6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	2,694	7,170	12,528	17,695	23,776	28,957	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,627	4,248	6,685	9,129	11,632	14,151	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	63	108	188	255	327	404	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,264	3,379	5,454	7,554	9,614	11,602	Economic Aid
3	Bonusi I lindjeve	300	500	700	900	1,200	1,400	Birth bonus
I.8	Transferime Kapitale	0	0	0	0	0	0	Capital transfers
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0	0	0	0	0	0	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	1,028	1,767	12,734	17,989	24,045	30,835	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	0	286	9,564	13,065	17,442	22,400	Domestically financing
2	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte	0	17	46	203	267	331	From higher education system's own revenues
3	Financimi Huaj	1,028	1,413	2,248	2,954	3,662	4,630	Foreign financed
IV	Fondi I rindertimit	0	50	876	1,767	2,674	3,475	Reconstruction fund
V.	DEFICITI	-14,922	23,646	30,876	34,555	35,997	46,157	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-14,922	-23,646	-30,876	-34,555	-35,997	-46,157	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-14,096	-20,819	-24,359	-21,931	-21,155	-91,831	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	5	9	17	20	23	26	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	10,909	5,506	12,662	20,312	27,542	33,632	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-25,010	-26,333	-37,038	-42,263	-48,720	-125,489	Others
V.3	I huaj	-826	-2,828	-6,517	-12,624	-14,842	45,674	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	962	1,961	2,097	2,349	2,441	2,141	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-189	-980	-709	-1,252	-896	204	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,599	-3,808	-7,905	-13,720	-16,387	-19,444	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	0	0	0	0	0	0	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source : Ministry of Finance and Economy

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

Tabela e investimeve 2023

Table of investments 2023

Të dhëna progresive (Progressive Data)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	
	January	February	March	April	May	June	
Financim i brendshëm	-14,096	-20,819	-24,359	-21,931	-21,155	-91,831	Domestic financing
Në %	94.5	88.0	78.9	63.5	58.8	199.0	In %
Financim i huaj	-826	-2,828	-6,517	-12,624	-14,842	45,674	Foreign financing
Në %	5.5	12.0	21.1	36.5	41.2	-99.0	In %
Totali	-14,922	-23,646	-30,876	-34,555	-35,997	-46,157	Total
Në %	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source: Ministry of Finance and Economy

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2023
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2023**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Taksë doganore	584	1,256	1,977	2,660	3,487	4,241	Customs Duties
TVSH	9,878	20,632	32,958	44,710	58,181	70,715	V.A.T
Akcizë	4,102	8,226	12,056	16,043	21,134	26,383	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	235	455	827	1,055	1,316	1,528	Others (Mineral Rent)
TOTALI	14,799	30,569	47,818	64,469	84,118	102,867	Total
TË ARDHURAT TATIMORE 2023 (TAX REVENUE)							
TVSH	7,099	9,887	12,944	15,787	18,647	22,294	V.A.T
Tatim mbi fitimin	2,397	4,875	21,608	25,831	29,262	33,827	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	5,258	9,063	13,236	18,112	22,800	27,792	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	3,788	6,528	9,068	11,769	14,341	17,593	National taxes
TOTALI	18,542	30,353	56,856	71,498	85,051	101,507	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	33,341	60,922	104,674	135,967	169,169	204,374	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source: Ministry of Finance and Economy

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2023

*The Deficit and Its Financing for 2023**Të dhëna progresive (Progressive Data)**Në milionë lekë (In million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
TË ARDHURAT	50,274	97,112	156,107	207,513	258,192	319,993	REVENUE
SHPENZIMET	35,352	73,466	125,232	172,957	222,195	273,836	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	14,922	23,646	30,876	34,555	35,997	46,157	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-14,922	-23,646	-30,876	-34,555	-35,997	-46,157	FINANCING
Financimi i brendshëm	-14,096	-20,819	-24,359	-21,931	-21,155	-91,831	Domestic
Të ardhura nga privatizimi	5	9	17	20	23	26	Privatization receipts
Hua-marrje e brendshme	10,909	5,506	12,662	20,312	27,542	33,632	Domestic borrowing
Të tjera	-25,010	-26,333	-37,038	-42,263	-48,720	-125,489	Others
Financimi i jashtëm	-826	-2,828	-6,517	-12,624	-14,842	45,674	Foreign
a. Hua afatgjatë(e marrë)	962	1,961	2,097	2,349	2,441	2,141	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-189	-980	-709	-1,252	-896	204	Chang. of stat. Account
c. Ripagesat	-1,599	-3,808	-7,905	-13,720	-16,387	-19,444	Repayments
d. Mbështetje Buxhetore	0	0	0	0	0	0	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë**Source:** Ministry of Finance and Economy

Tab - 8

BILANCI I PAGESAVE*Balance of payments**Në milion Euro**In millions Euro*

	2019	2020	2021	2022	T1-2023	
Llogaria korrente	-1,088.70	-1,152.73	-1,186.26	-1,080.28	-135.19	Current Account.
Bilanci tregtar	-3,143.80	-2,982.51	-3,829.34	-4,269.05	-890.93	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	906.50	793.63	1,264.79	1,932.55	486.85	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-4,050.30	-3,776.14	-5,094.13	6,201.59	1,377.78	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	1,263.90	1,051.72	1,776.10	2,401.33	564.17	Services Balance.
Shërbimet Kredi	3,404.60	2,226.22	3,466.03	4,801.38	1,198.01	Services Credit
Shërbimet Debi	2,140.70	1,174.50	1,689.93	2400.05	633.84	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	-180.10	-219.34	-210.98	-331.63	-79.17	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	420.20	337.10	397.57	579.93	149.68	Income Credit
Të ardhurat Debi	-600.30	-556.44	-608.55	911.54	228.85	Income Debt
Bilanci i transfertave	971.30	997.40	1,077.96	1,441.37	348.64	Balance of Transfers
Transferta private	1,105.50	1,169.70	1,244.00	1,280.21	309.69	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	-134.20	-172.30	-166.04	161.16	38.95	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	76.10	143.60	358.46	20.13	-27.54	Capital Account
Llogaria financiare	-827.00	-1,504.31	-1,554.51	-844.01	-148.17	Financial Account
Investime direkte	-1,036.30	-893.56	-989.93	-1,206.81	-263.84	Direct Investment
Investime portofoli	140.60	-65.85	-83.95	572.81	10.69	Portfolio Investment
Investime të tjera	50.90	-403.80	-534.17	-272.49	85.11	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	107.90	159.33	209.47	146.33	97.84	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	-77.70	654.51	936.18	-69.80	83.28	Overall Balance
Rezervat	-77.70	654.70	936.17	-69.80	83.28	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-17.80	141.10	-53.54	-62.48	-19.86	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundit i perludhes					2023	2023	2023	2023	2023	2023	2023	2023
	2019	2020	2021	2022	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Millions of Lek End of Period	
Mjete valutore neto	733,114	803,487	937,814	892,687	923,043	909,583	896,913	877,361	880,523	927,585	Net foreign assets	
Pretendime ndaj jorezidentëve	794,006	860,750	1,027,069	981,133	1,013,021	993,155	983,219	961,183	964,146	1,007,745	Claims on nonresidents	
Minus Detyrime të jorezidentëve	60,892	57,263	89,255	88,446	89,978	83,572	86,306	83,822	83,623	80,161	Minus: Liabilities to nonresidents	
Mjetet e brendshme	950,426	1,047,835	1,084,106	1,211,348	1,227,452	1,215,126	1,211,224	1,207,562	1,209,854	1,138,568	Domestic assets	
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	378,524	435,613	412,253	491,750	509,869	499,139	494,123	490,630	491,043	419,152	Net claims on central government	
Pretendime ndaj sektoreve te tjere	571,902	612,221	671,852	719,598	717,583	715,987	717,101	716,932	718,811	719,416	Claims on other sectors	
Detyrimet e parasë së gjërë	1,318,662	1,456,993	1,582,310	1,659,293	1,682,906	1,665,290	1,651,678	1,639,769	1,637,161	1,633,690	Broad Money liabilities	
Paraja jashtë Korporatave Depozituese	291,409	344,560	366,251	387,652	387,505	385,104	382,754	385,121	384,130	389,014	Money outside depository corporations	
Depozita të transferueshme	408,780	490,394	584,631	645,637	660,677	649,048	642,476	634,412	634,491	638,560	Transferable deposits	
Depozita të tjera	618,473	622,039	631,428	626,005	634,724	631,138	626,448	620,236	618,540	606,116	Other deposits	
Depozita të papërfshira në paranë e gjërë	178,375	186,892	222,409	248,219	257,177	257,367	259,043	257,819	256,276	256,998	Deposits excluded from Broad Money	
Qeveria lokale dhe administrata publike											Local government and public administration	
Korporata të tjera financiare	3,879	4,666	5,877	7,250	7,376	7,100	7,402	7,352	6,894	7,071	Other financial corporations	
Korporata jofinanciare publike	336	252	392	382	383	384	384	384	383	383	Public nonfinancial corporations	
Korporata të tjera jofinanciare	8,238	6,925	16,599	10,186	10,411	9,775	10,892	11,481	12,606	12,389	Other nonfinancial corporations	
Sektorë të tjerë rezidentë	165,922	175,050	199,541	230,401	239,007	240,108	240,366	242,374	244,940	243,926	Other resident sectors	
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	6,656	5,926	7,288	7,925	8,020	7,942	8,834	8,750	8,757	7,773	Securities other than shares	
Korporata të tjera jofinanciare	101	57	67	291	292	288	311	288	312	306	Korporata të tjera jofinanciare	
Sektorë të tjerë rezidentë	6,555	5,869	7,221	7,634	7,728	7,654	8,522	8,462	8,445	7,467	Other resident sectors	
Huatë	2,527	3,757	3,507	4,636	8,793	9,787	6,141	10,165	5,008	5,015	Loans	
Qeveria lokale dhe administrata publike											Local government and public administration	
Korporata të tjera financiare	2,527	3,757	3,507	4,636	8,793	9,787	6,141	10,165	5,008	5,015	Other financial corporations	
Korporata jofinanciare publike											Public nonfinancial corporations	
Korporata të tjera jofinanciare											Other nonfinancial corporations	
Sektorë të tjerë rezidentë											other resident sectors	
Llogari të pagueshme	229	62	248	86	108	217	79	190	45	58	Accounts payable	
Korporata të tjera Financiare											Other financial corporations	
Korporata jofinanciare publike											Public nonfinancial corporations	
Korporata të tjera jofinanciare	1	5		69	1	7	0	167	1	0	Other nonfinancial corporations	
Sektorë të tjerë rezidentë	229	57	247	17	107	211	78	23	44	58	other resident sectors	
Aksione dhe instrumenta të tjerë të kapitalit	200,257	214,394	219,725	185,627	200,097	200,599	191,664	185,175	187,072	172,438	Shares and other equity	
Nga të cilat rezerva rivlerësimi	-2,652	-1,095	-5,442	-46,110	-34,632	-42,251	-46,571	-55,509	-56,924	-75,368	Of which: Valuation adjustment	
Të tjera neto	-23,895	-17,621	-14,428	-12,607	-13,848	-18,044	-11,368	-20,051	-13,829	-17,757	Other items net	
Detyrime të tjera	50,220	55,892	59,094	63,859	62,687	56,618	62,960	55,278	61,684	57,210	Other liabilities	
Minus: Mjete të tjera	74,115	73,514	73,521	76,467	76,535	74,662	74,327	75,329	75,513	74,967	Minus: Other assets	
Axhustimi i konsolidimit	729	919.0	862	4,826	1,173	1,551	2,066	-687	1,338	1,167	Consolidation adjustment	

Burlmi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab -
10 **KREDIA PËR EKONOMINË**
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2019	2020	2021	2022	2023 Janar January	2023 Shkurt February	2023 Mars March	2023 Prill April	2023 Maj May	2023 Qershor June	Million of Lek End of Period
Totali i kredisë	570,792.2	608,779.8	666,178.4	713,289	711,525.5	709,935.9	711,060.8	710,758.8	712,643.7	713,271.2	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale dhe administratën publike	560.6	429.1	313.2	205	197.2	191.6	178.2	174.8	167.0	153.5	Credits to local Government
Në lekë	560.6	429.1	313.2	205	197.2	191.6	178.2	174.8	167.0	153.5	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	24,182.4	15,150.8	22,521.8	23,714	22,639.4	22,620.2	20,752.9	21,163.0	18,938.1	19,219.0	Credits to Public Non-financial Corporations
Në lekë	18,489.7	11,819.6	9,210.6	10,509	9,148.8	9,443.1	7,938.8	8,780.5	8,926.2	9,337.4	in Lek
Në valutë	5,692.7	3,331.2	13,311.3	13,205	13,490.6	13,177.1	12,814.1	12,382.5	10,011.9	9,881.6	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera jofinanciare	335,884.5	370,356.3	395,162.7	411,853	407,332.3	405,116.4	405,170.1	403,579.6	405,701.5	404,347.3	Credits to other Non-financial Corporations
Në lekë	141,240.5	161,975.3	172,000.2	173,607	169,606.3	169,711.7	171,992.7	174,403.5	178,416.2	182,482.1	in Lek
Në valutë	194,644.1	208,381.0	223,162.5	238,246	237,726.0	235,404.7	233,177.4	229,176.1	227,285.3	221,865.2	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	13,555.1	13,169.1	13,815.7	15,557	15,839.8	15,875.2	16,403.0	16,540.9	16,673.6	16,797.9	Credits to Other Financial Corporations
Në lekë	8,023.8	7,489.2	7,772.8	8,669	8,709.3	8,910.3	9,061.1	9,087.7	9,293.1	9,310.7	in Lek
Në valutë	5,531.3	5,679.9	6,043.0	6,888	7,130.5	6,964.9	7,341.9	7,453.2	7,380.5	7,487.2	in Foreign Currency
Kredia për sektorë të tjerë rezidentë	196,609.5	209,674.5	234,365.0	262,223	265,516.8	266,132.5	268,556.8	269,300.4	271,163.6	272,753.7	Credits to other resident sectors
Në lekë	130,409.2	138,986.4	158,093.0	175,901	175,884.0	176,033.4	177,500.4	179,405.3	182,005.4	185,669.0	in Lek
Në valutë	66,200.3	70,688.1	76,272.0	86,322	89,632.8	90,099.1	91,056.4	89,895.1	89,158.2	87,084.7	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11

OFERTA E PARASË

Money Supply

Mujor-Monthly

Në million Lekë	2019	2020	2021	2022	2023	2023	2023	2023	2023	2023	Millions of LEK End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	
Fundi i perludhës											
Baza monetare	433,951	480,352	573,510	539,812	547,780	544,288	543,057	524,237	517,856	566,730	Monetary base
Paraja jashtë korporatave depozituese	291,409	344,560	366,251	387,652	387,505	385,104	382,754	385,121	384,130	389,014	Currency outside depository corporations
Agregati M1	523,968	637,317	701,404	735,839	740,218	732,161	728,380	726,140	724,464	735,732	M1 Aggregate
Agregati M2	758,022	862,338	918,474	939,309	943,595	935,575	932,028	928,434	926,096	936,837	M2 Aggregate

Burimi : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundl perludhës	2019	2020	2021	2022	2023 Janar January	2023 Shkurt February	2023 Mars March	2023 Prill April	2023 Maj May	2023 Qershor June	Millions of Leks End of Period
Totali depozitave	1,027,253	1,112,433	1,216,059	1,271,642	1,295,401	1,280,186	1,268,925	1,254,648	1,253,031	1,244,676	Total of deposits
Në lekë	466,613	517,778	552,223	551,657	556,090	550,471	549,275	543,312	541,966	547,823	
Depozitat e transferueshme	190,538	241,316	276,074	291,263	296,645	291,018	289,398	285,494	285,689	290,825	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	1,624	1,644	1,302	1,694	1,664	1,738	1,663	1,699	1,742	1,798	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	10,667	13,747	17,118	16,031	17,539	17,319	16,808	17,275	18,389	16,737	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	3,694	3,666	4,744	7,045	6,277	5,769	6,639	4,449	4,094	4,736	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	49,099	66,074	77,758	77,667	83,716	77,057	74,770	72,836	73,290	77,270	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	125,454	156,185	175,154	188,826	187,449	189,135	189,518	189,235	188,175	190,283	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	42,021	51,442	59,079	56,924	56,068	56,039	56,228	55,525	54,645	55,893	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike											Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	120	166	1,762	2,636	1,534	1,534	1,566	1,548	1,549	1,437	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	87	131	78	37	2	20	15	15	15	15	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,873	3,970	3,554	2,493	2,917	2,941	3,060	3,038	2,613	3,831	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	38,942	47,175	53,686	51,758	51,615	51,544	51,587	50,924	50,468	50,610	Other resident sectors
Depozita të tjera	234,053	225,021	217,070	203,470	203,377	203,415	203,648	202,293	201,632	201,105	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	10	10									Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	709	1,465	757	598	598	598	599	599	600	599	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	4,147	4,868	5,136	5,114	4,930	4,609	4,747	4,513	4,413	4,607	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	7,978	6,836	7,598	6,379	6,488	6,653	7,080	7,018	7,195	7,272	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	221,210	211,841	203,579	191,379	191,361	191,555	191,223	190,163	189,424	188,627	Other resident sectors
Në valutë	560,640	594,655	663,836	719,985	739,311	729,715	719,650	711,336	711,065	696,853	In foreign currency
Depozitat e transferueshme	218,241	249,078	308,556	354,374	364,032	358,030	353,079	348,918	348,802	347,735	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	158	82	39	76	69	170	89	62	75	59	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	2,688	2,246	2,465	3,901	4,640	4,308	4,561	4,411	3,984	5,934	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	5,360	6,742	6,143	6,598	8,342	7,323	7,773	7,085	6,451	6,345	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	79,001	90,281	116,544	136,911	139,934	136,952	134,617	135,045	135,186	136,415	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	131,036	149,726	183,366	206,889	211,045	209,277	206,038	202,315	203,106	198,983	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	106,417	120,699	136,407	139,409	143,118	138,463	135,413	132,265	131,556	128,030	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike											Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	136	97	94	101	106	102	96	96	97.07	93.87	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	1	1	10	1	0	10	9	9	7	7	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,786	5,845	3,739	4,702	6,872	5,158	5,482	5,254	4,950	5,535	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	103,495	114,755	132,565	134,605	136,139	133,193	129,827	126,906	126,502	122,395	Other resident sectors
Depozita të tjera	235,982	224,878	218,873	226,202	232,162	233,222	231,158	230,151	230,707	221,088	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike			24	984	234.5	231.7	204.4	206.5	116.2	112.9	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	1,522	1,732	1,519	2,607	3,520	3,203	3,139	3,084	2,918	863	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	7,058	6,939	8,936	7,561	6,050	6,973	7,181	6,907	8,016	7,736	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	11,662	10,854	12,622	23,903	23,904	24,679	24,746	26,796	25,946	22,173	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	215,741	205,353	195,771	191,147	198,454	198,135	195,887	193,159	193,710	190,202	Other resident sectors

Burlimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 13 **Tregues të shëndetit financiar (FSI)**
(në përqindje)

							Financial Soundness Indicators (FSI)
							(in percentage)
Përshkrimi i treguesit	Janar'23	Shkurt'23	Mars'23	Prill'23	Maj'23	Qershor'23	Index description
Tregues me bazë kapitalin							Capital-based
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)			19			19	Regulatory capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali rregullator (mln lekë)			179,418			178,368	Regulatory capital (million lek)
Aktive të ponderuara me rrezik (mln lekë)			949,150			938,845	Risk-weighted assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)			17.45			17.65	Regulatory Tier 1 capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali ndaj totalit të aktiveve							Capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve	8.64	8.63	8.85	8.81	8.81	8.89	Regulatory Tier 1 capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve (në %)	9.30	9.31	9.58	9.54	9.52	9.57	Regulatory capital as a percent of total assets (in %)
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve (në %)	9.86	10.07	9.75	9.83	9.94	10.01	Shareholders' equity as a percent of total assets (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit (në %)							Nonperforming loans net of provisions as a percent of capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	7.85	8.24	7.90	7.85	7.88	7.90	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory Tier1 capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator (në %)	7.29	7.64	7.29	7.25	7.29	7.34	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit aksioner (në %)	6.88	7.06	7.17	7.03	6.98	7.01	Nonperforming loans net of provisions as a percent of shareholders' equity (in %)
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore) (në %)	14.52	17.01	14.58	14.58	15.07	15.87	Return on equity (ROE) (annual basis) (in%)
Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit (në %)							Net open position in foreign exchange as a percent of capital (in %)
Pozicioni i hapur neto ne valutë ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	5.54	7.87	7.15	6.53	5.08	5.89	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory Tier 1 capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator (në %)	5.15	7.30	6.60	6.04	4.70	5.47	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner (në %)	4.86	6.75	6.48	5.85	4.50	5.23	Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %)
Tregues me bazë aktivet							Asset-based Indicators
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda e gjerë)	30.98	30.20	30.04	29.52	28.87	29.70	Liquid assets as a percent of total assets (broad measure)
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda bazë)	11.65	11.35	29.32	29.08	28.55	29.38	Liquid assets as a percent of total assets (core measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda e gjerë)	42.89	42.22	41.66	41.40	40.85	41.94	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (broad measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda bazë)	16.12	15.86	40.67	40.79	40.40	41.50	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (core measure)
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore) (fitimi neto para taksave)	1.74	2.01	1.70	1.69	1.74	1.84	Return on assets (ROA) (annual basis) (net profit before taxes)
Huatë me probleme (bruto) ndaj totalit të huave (në %)	5.10	5.16	5.15	5.18	5.23	5.20	Nonperforming loans (gross) as a percent of total loans (in %)
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve							Income and expense-based
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	87.44	77.05	82.66	82.68	81.96	81.42	Interest margin to gross income
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	53.32	49.45	53.09	53.65	53.08	52.53	Noninterest expenses to gross income
Të tjera							Other
Numri i bankave	11.00	11.00	11.00	11.00	11.00	11.00	Number of banks

Burimi : Banka e Shqiperisë

Source : Bank of Albania